

PUKË

**POP
2019**

**PERBALLJA
OFERTAVE
POLITIKE**



KONTRATA SOCIALE

Mbështetur nga:



Zbatuar nga:



Rr. "Abdyl Frasheri"
Pallati 1/10, shk.1, ap.3 Tirane



gadc@gadc.org.al



+355 4 22 555 14



www.popalbania.info



+355 68 20 59 301



+355 4 22 555 14

Rreth Projektit

Përballja e Ofertave Politike – POP 2019, është një nismë e rrjetit të 11 organizatave të shoqërisë civile shqiptare në kuadër të zgjedhjeve të ardhshme lokale të 30 Qershorit 2019.

POP 2019 synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët mbi platformat elektorale të partive dhe kandidatëve për kryetarë bashkie, si dhe orientimin e këtyre platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien gjatë zgjedhjeve dhe periudhës pas tyre.

POP është zbatuar suksesshëm gjatë Zgjedhjeve Parlamentare 2013, Zgjedhjeve Lokale të vitit 2015 dhe Zgjedhjeve Parlamentare 2017. Kjo nismë është mbështetur dhe mbështetet nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme, me fonde të Ambasadës Suedeze në Tiranë.

POP 2019 do të organizohet në bashkitë Durrës, Fier, Kamëz, Kukës, Pogradec, Pukë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë aty ku organizatat e rrjetit ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

POP 2019 synon:

Të nxisë dialogun mes zgjedhësve dhe kandidatëve, por edhe ndërmjet kandidatëve vetë, duke shërbyer si një platformë diskutimi, ku kandidatët do të mbahen të përgjegjshëm ndaj premtimeve të tyre dhe do të ftohen të nënshkruajnë Kontratën Sociale mes tyre dhe qytetarëve në çdo bashki.

Përmes mjeteve të avokimit / lobimit rrjeti POP 2019 do të përpiqet të arrijë rezultate, duke siguruar që kontratat sociale të mos jenë thjesht një zotim i shkruar, por një angazhim i vazhdueshëm për kryetarët e ardhshëm të bashkive.

Të informojnë qytetarët duke përdorur mediat sociale në lidhje me premtimet dhe përparësitë e kandidatëve dhe partive politike përkatëse si dhe në lidhje me punën që do të kryejnë të zgjedhurit për t'i përbushur ato. Përveç kësaj, faqja online interaktive, do t'u ofrojë qytetarëve shqiptarë një paraqitje shumë të nevojshme të ofertave të partive politike. Të rrisë transparencën dhe llogaridhënien e të zgjedhurve gjatë fushatës elektorale, por edhe gjatë mandatit.

Aktivitetet që do të organizohen në kuadër të POP 2019, ofrojnë mundësi të paanshme dhe të barabarta për të gjitha palët dhe kandidatët në dhënien dhe paraqitjen e objektivave dhe platformave të tyre politike për qytetarët. Diskutimet midis kandidatëve nga parti të ndryshme nxisin politikanët të komunikojnë në mënyrë qytetare me njëri-tjetrin dhe synojnë të japin një shembull të mirë për publikun e gjerë në lidhje me kuptimin dhe mbështetjen që politikanët i ofrojnë komuniteteve të tyre pavarësisht bindjeve politike.

Në qendër të të gjitha aktiviteteve të POP 2019 do të jenë qytetarët me nevojat dhe shqetësimet e tyre, pasi zhvendosja e debatit publik nga politika drejt platformave politike në periudhën parazgjedhore është e rëndësishme. POP 2019 është një mundësi për partitë politike që të paraqesin programet e tyre të tregojnë se sa do të kujdesen për qytetarët në katër vitet e ardhshme. Premtimet e partive politike dhe programet e tyre do të monitorohen pas Zgjedhjeve Lokale 2019 nga Rrjeti i organizatave të POP 2019 dhe grupet e qytetarëve që do të organizohen nga ky rrjet.

ORGANIZATAT

- | | |
|--|--|
| • Qendra "Aleanca Gjimore për Zhvillim", Tiranë | • Intelktualët e Rinj "Shpresë", Shkodër |
| • Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës | • Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë |
| • Qendra Rinore Vlorë | • Qendra Rinore për Progres, Kukës |
| • ACPD/Qendra "Aulona", Vlorë | • Integrimi, Aktivizimi dhe Ndërgjegjësimi i të Rinjve, Pogradec |
| • Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz | • Lëvizja "Mjaft" |
| • Epoka e Re, Fier | |

PROCESI I FORMULIMIT TË PRIORITETEVE

Banorë të Bashkisë Pukë u përfshinë në 3 Forume, të zhvilluara gjatë muajit mars 2019 me qëllim identifikimin e prioriteteve të zhvillimit vendor në këndvështrimin qytetar. Në secilin prej tre Forumeve u përfshinë qytetarë të grup-moshave dhe gjinive të ndryshme, të punësuar dhe të papunë, si dhe studentë, shtëpiake apo persona të grupeve të marginalizuara.

Pjesëmarrja sipas gjinive

Burra	50 %
Gra	50 %

Në çdonjërin prej forumeve të zhvilluara qytetarët diskutuan gjerësisht mbi 23 çështje që përfshihen në katër fusha kryesore që ndikojnë drejtpërdrejtë mbi komunitetin vendor:



Shërbimet publike



Zhvillimi ekonomik vendor



Dimensioni social




Demokracia vendore

Për secilën prej 26 çështjeve objekt diskutimi qytetarët dhanë këndvështrimin e tyre mbi gjendjen aktuale, si dhe diskutuan mbi çështjet që përbëjnë prioritet për ta e për rrjedhojë duhet të përfshihen në axhendën e të zgjedhurve vendor.

Mbi bazën e vlerësimit të vetë pjesëmarrësve prioritetet e komunitetit u organizuan në tre grupe:

1. **Ndërhyrje prioritare**, ku përfshihen çështjet që në këndvështrimin e komunitetit janë shumë të rëndësishme për ta dhe kërkojnë më shumë angazhim në vijim nga të zgjedhurit vendorë;
2. **Ndërhyrje disi prioritare**, që përfshijnë ato çështje që janë më pak të rëndësishme krahasuar me grupin e parë;
3. **Vijueshmëri**, përfshin çështje të cilat kanë arritur zhvillimin e pritshëm nga komuniteti dhe për to nevojitet vetëm ruajtje e të njëjtit standart nga të zgjedhurit vendorë.



27 janë prioritetet dhe 8 kërkesat e komunitetit të prezantuara gjerësisht në vijim, sipas shkallës së rëndësisë që i ka dhënë vetë komuniteti, për të cilat do të lobohet për të qenë pjesë e axhendës së të zgjedhurve të rinj vendor, sikurse përm-bushja e të cilave do të moni-torohet në vijim nga vetë komuniteti.

PRIORITETET E KOMUNITETIT

Grupi i parë / NDËRHYRJE PRIORITARE

Janë **12 çështje** për të cilat komuniteti ka vlerësuar se janë shumë prioritare.

ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR  • Planifikimi strategjik • Incentivat për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës • Nxitja e bizneseve të rinjve dhe grave • Nxitja e punësimit • Programe në mbështetje të fermerëve	SHËRBIMET PUBLIKE  • Cilësia e rrugëve dhe trotuareve • Ndriçimi • Transporti Publik • Kanalet kulluese vaditëse	DIMENSIONI SOCIAL  • Grupe në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror¹ • Romët dhe Egjiptianët • Gratë
---	---	--

Grupi i dytë / NDËRHYRJE DISI PRIORITARE

Janë **6 çështje** për të cilat komuniteti ka vlerësuar se janë disi prioritare.

SHËRBIMET PUBLIKE  • Pastrimi • Furnizimi me ujë të pijshëm • Pyjet dhe kullotat	DEMOKRACIA VENDORE • Pjesëmarrja në vendimarrje	ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR • Mbështetja për fermerët • Mbledhja e të ardhurave dhe planifikimi i buxhetit
--	--	--

Grupi i tretë/ NDËRHYRJE VIJUESE

Janë **5 çështje** për të cilat komuniteti i bashkisë Pukë ka dhënë vlerësimet më të larta dhe kërkojnë nga bashkia që të vijojnë të punojnë dhe të mbajnë standartet.

SHËRBIMET PUBLIKE  • Gjelbërimi • Shkollat • Kopshtet dhe çerdhet	DEMOKRACIA VENDORE  • Informimi dhe komunikimi • Transparenca në vendimarrje
---	---

¹ Në këto grupe përgjithësisht përfshihen: të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, familjet përfituese të ndihmës ekonomike, viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit, persona të pastrehë, fëmijët pa kujdes prindëror, përdorues të alkoolit apo drogave etj.

● ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR ●

PLANIFIKIMI STRATEGJIK

Të gjitha njësitë e përfshira në forumet e organizuara në bashkinë Pukë listojnë si prioritet planin strategjik për zhvillim territorial dhe ekonomik të kësaj bashkie, duke qenë se njëzëri nuk kishin informacion nëse egzistonte apo jo.

Prioritet 1: Informacion për qytetarët në lidhje me egzistencën, përmbajtjen sidomos në lidhje me gratë, të rinjtë, fermerët dhe grupeve në nevojë.

INCENTIVAT PËR NXITJEN E BIZNESIT DHE KRIJIMIN E VENDEVE TË REJA PUNËS

Ka pak informacion mbi incentivat që përdor Bashkia për të nxitur biznesin dhe krijuar vende të reja pune. Nxitja e biznesit konsiderohet prioritare nga komuniteti me qëllim krijimin e vendeve të reja të punës. *"Bashkia nuk është miqësore me biznesin privat"*² Banorët kërkojnë projekte të mirëfillta që nxisin biznesin dhe rrjedhimisht krijojnë vende të reja pune.

Sipas banorëve në Pukë ka biznese që vijnë nga Saranda për projekte të bashkisë p.sh dhe marrin punëtorët me vete, kështu që qytetarët e kësaj bashkie nuk kanë përfitime nga këto lloj investimesh. Pikërisht pamundësia për punë po bën që popullsia të emigrojë në një numër të konsiderueshëm banorësh.

Prioritet 2: Zhvillimi i incentivave për nxitjen e biznesit i cili përfshin banorët e Pukës si të punësuar.

Prioritet 3: Informimi i gjerë i grave dhe të rinjve mbi programet për nxitjen e biznesit dhe procesin e aplikimit për tu përfshirë në këto programe. Favorizimi i bizneseve të të rinjve dhe grave në lidhje me taksat dhe procedura të lehtësuara.

NXITJA E PUNËSIMIT

"Banorët shprehen se nxitja e punësimit është një nga prioritetet e banorëve dhe që duhet të jetë prioritare në axhendat e kandidatëve për Kryetar Bashkie në Pukë." Të rinjtë shprehen se ka nevojë për programe të cilat nxisin punësimin për grupet me nevoja të veçanta, gratë, vajzat dhe të rinjtë e ndjejnë më shumë mungesën e mbështetjes. Gjithashtu ky komunitet kërkon që të zhvillohen kurse profesionale që jo vetëm sjellin vende të reja pune por çojnë edhe në ruajtjen e traditës – kurse të tilla si poçeri, kostumet popullore, qendistrari, tezgjah, kulinari tradicionale etj të ngjashme.

Prioritet 4: Programet e Bashkisë për nxitjen e punësimit të prioritojnë grupet më pak të avantazhuara në tregun e punës:

- Të rinjtë e sapo diplomuar.
- Gratë.
- Gratë viktimat të dhunës në familje.

PROGRAME NË MBËSHTETJE TË FERMERËVE

Fermerët nuk marrin subvencione. Nuk përfitojnë për shumë arsye: për shkak të ngastrave të vogla, për shkak të kulturave që mbjellin ose për shkak të mos regjistrimit të pronave tek Zyra e Regjistrimit të Pasurive.

Sipas banorëve, bashkia duhet të ngrejë një grup i cili i ndihmon fermerët për të kryer aplikimet përkatëse. Kjo si procedurë është bërë më parë por nuk është bërë për të gjitha zonat e njësive administrative të Pukës ndaj kërkohej që të ndiqet edhe për njësitë e tjera administrative. Gjithashtu mungon edhe lidhja e fermerëve me tregun.

Prioritet 5: Zhvillimi i programeve për mbështetjen e fermerëve, krijimi i mundësisë për dhënien e subvencioneve.

Prioritet 6: Lehtësimi i procedurave për aplikim ose/dhe këshillimi nga grupe pune të specializuara.

Prioritet 7: Adresimi i mundësisë së lidhjes së fermerëve me tregun nga ana e bashkisë.

● SHËRBIMET PUBLIKE ●

CILËSIA E RRUGËVE DHE TROTUAREVE

Përfaqësuesit e komunitetit të bashkisë Pukë listuan si prioritet të lartë edhe rregullimin e rrugëve dhe trotuareve. *"Rruga kryesore nacionale është përmirësuar gjatë vitit që shkoi por rruga që lidh Gjegjanin me Pukën në segmentin Rrapë është tejet i amortizuar."*³ Rrugët që lidhin fshatrat me njesinë vendore janë jashtë standartit dhe të kalueshme me automjete vetëm në kohë të thatë. Gjithashtu edhe në qytetin e Pukës, rrugët e zonave periferike janë problematike. *"Rruga naza pranë elektrikut është shumë e dëmtuar"*⁴

- Të rehabilitohet tuneli në Gojan i cili paraqet rrezikshmëri për kalimtarët dhe autometet.
- Të rehabilitohet rruga e varrezave Kalivarë – Gjegjan – Haxhiaj
- Rikonstruksioni i rrugëve të periferisë Kukaj – Zezaj – Kurtaliaj – Lajthizë – Mehaj – Laçaj

Prioritet 8: Adresimi me prioritet i rregullimit të rrugëve në nivel bashkie.

SHËRBIMET PUBLIKE

NDRIÇIMI

"Ndriçimi mungon totalisht, përveç qendrës"⁵, shërbim i cili është rregulluar para një viti. Edhe në qytetin e Pukës, rrugët periferike kanë probleme të mëdha me ndriçimin dhe sinjalistikën.

Prioritet 9: Adresimi me prioritet i rregullimit të sinjalistikave dhe ndriçimit edhe në rrugët periferike.

TRANSPORTI PUBLIK

Banorët e bashkisë Pukë e vlerësojnë si shumë prioritar për ndërhyrje edhe transportin publik. Nuk ka një shërbim të tillë në qytet dhe as në fshatrat kufizuese. Banorët e Lajthizë, Kukaj, Zezaj, Mehaj dhe Laçaj shprehen se mungesa e transportit është një pengesë e madhe për jetesën e tyre të përditshme, sidomos për banorë të cilët punojnë në qytetin e Pukës, të cilët duhet që të përshkrojnë distanca të largëta në këmbë ose të marrin taksì private.

"Transporti publik është vetëm dy herë në ditë dhe i

pamjaftueshëm për nevojat e lëvizjes. Për shkollat e largëta nuk ofrohet transport sepse nuk ka rrugë që mund të kalojnë automjetet."⁶

Prioritet 10: Adresimi me prioritet i vendosjes së transportit publik, sidomos në ato zona i cili mungon totalisht.

KANALET KULLUESE VADITËSE

Megjithëse është bërë më herët punë në lidhje me kanalet kulluese vaditëse, dhe aty ku janë egzistente në përgjithësi cilësia dhe gjendja e tyre është e mirë. Por, banorët shprehin problematikën e mungesës së këtyre kanaleve në shumicën e fshatrave, si dhe, mungesën e pastrimit të tyre (aty ku egzitojnë) nga ana e bashkisë.

Prioritet 11: Ngritja e kanaleve kulluese/vaditëse në të gjitha zonat ku e kanë të nevojshme si dhe mirëmbajtja e kanaleve egzistuese nga ana e bashkisë.

DIMENSIONI SOCIAL

GRUPE NË NEVOJË PËR SHËRBIME TË KUJDESIT SHOQËROR

Sipas komunitetit të Pukës, bashkia nuk ka shërbime sociale të ngritura për individë në nevojë për shërbime si shërbim në familje për persona me aftësi të kufizuara ose të moshuar, qendra komunitare për familjen dhe fëmijën, qendra ditore për persona me aftësi të kufizuara, për të moshuar etj. "Është një qendër ditore për moshën e tretë por që përveç ambjentit nuk ofron asgjë tjetër"⁷. Ndërkohë që në fshatra nuk ka shërbime të tilla.

Gjithashtu banorët janë shprehur se nuk ka shërbime rehabilituese të ngritura nga Bashkia për viktimat e dhunës në familje, shërbime të tilla si: shërbime psikologjike, këshillim ligjor, strehim emergjence etj. "Qendra kulturore e Gjegjamit, të vihet në dispozicion dhe në dobi të moshës së tretë dhe aktiviteteve për të rinjtë."⁸

Prioritet 12: Adresimi dhe listimi prioritar për ngritjen e shërbimeve për grupe në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror.

Prioritet 13: Ngritja e shërbimeve rehabilituese për viktimat e dhunës në familje.

KOMUNITETI ROM DHE EGJIPTIAN

Megjithëse numri i banorëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian është i vogël në bashkinë e Pukës 5 – 6 familje, banorët shprehen se nuk ka programe të veçanta për mbrojtjen dhe garantimin e te drejtave dhe përfshirjen sociale të këtyre grupeve, si dhe puna e bashkisë ndaj këtyre komuniteteve është shumë e dobët.

Prioritet 14: Adresimi i mungesave dhe krijimi i programeve të veçanta për mbrojtjen dhe garantimin e përfshirjes sociale të këtyre komuniteteve edhe pse në numër të vogël.

GRATË

Banorët shprehen se përfaqësimi i grave në administratën e bashkisë është i mirë, por krejt e kundërta në Këshillin Bashkia, ku nga 15 anëtarë vetëm 3 janë gra, që sipas banorëve nuk i përfaqësojnë siç duhet. Gjithashtu banorët shprehen se bashkia nuk ka programe të veçanta për adresimin e dhunës me bazë gjinore si dhe fushatat e ndërgjegjësimit ndërmarrë nga bashkia kundër dhunës ndaj gruas janë shumë të rralla ose jo egzistente.

Prioritet 15: Balancimi gjinor për Këshillin Bashkia
Prioritet 16: Ngritja e programeve dhe organizimi i fushatave ndërgjegjëse kundër dhunës me bazë gjinore.

SHËRBIMET PUBLIKE

PASTRIMI

Shërbimi dhe cilësia e pastrimit në qytet vlerësohet e mirë, por banorët shprehen se në zonat periferike mungojnë koshat dhe pastrimi sistematik neglizhohet nga punonjësit përgjegjës. *"Pastrimi kryhet rrallë, dhe pas mbledhjes së mbeturinave, është vënë re se kompania përgjegjëse i hedh në përrenj, gjithashtu mungojnë koshat⁹".*

Prioritet 17: Unifikimi i shërbimit dhe cilësisë së pastrimit për të gjitha zonat që janë pjesë e bashkisë Pukë. Shtimi i koshave në njësitë administrative dhe zonat periferike ku mungojnë dhe kontrolli më i shpeshtë nga bashkia.

Prioritet 18: Adresimi i problematikës së hedhjes së mbetjeve në përrenj dhe gjetja sa më parë e alternativave që nuk ndotin ambjentin.

FURNIZIMI ME UJË TË PIJSHËM

Në qytet furnizimi me ujë të pijshëm është shumë mirë dhe klorinimi bëhet në mënyrë të rregullt, por problematike mbeten fshatrat të cilat kanë probleme serioze me furnizimin me ujë, cilësinë dhe kloriminin e tij. *"Uji gjatë muajve të ngrohtë të verës vjen rrallë dhe me orare si dhe klorinimi i tij nuk kryhet në mënyrë të rregullt."¹⁰*

Problematika ka gjithashtu edhe në furnizimin me ujë të pijshëm të shkollave të bashkisë Pukë.

Prioritet 19: Adresimi dhe rregullimi i furnizimit me ujë të shkollave si dhe rregullimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe kontrolli i cilësisë së tij nëpër fshatra.

PYJET DHE KULLOTAT

Banorët shprehen se për t'u ngrohur përdorin drutë që i blejnë nga kompania që ka fituar tenderin për dru zjarri. Kullotat i kanë të ndara sipas pronësisë së tokave dhe pyjeve dhe nuk kanë hasur probleme për kullotat, megjithatë, ata shprehen se dëmtimet, zjarret gjatë stinës së verës ndodhin shumë shpesh dhe nuk janë marrë masa nga bashkia për parandalimin e tyre. *"Gjithashtu, ka probleme me një zonë pyjore (kullota) të cilat janë dhënë në përdorim nga bashkia personave që nuk janë banorë të zonës, ndërkohë që këta të fundit pengohen për të shfrytëzuar këto pasuri që janë të tyre – theksohet se bashkia këto pyje dhe kullota nuk i ka të regjistruara si prona të saj."¹¹* Banorët kërkojnë gjithashtu që pushteti vendor duhet të investojë në pyllëzimin e vazhdueshëm.

Prioritet 20: Marrja dhe adresimi i masave parandaluese nga bashkia Pukë kundër dëmtimit të pyjeve dhe kullotave.

Prioritet 21: Zgjidhja e problematikës së banorëve në lidhje me zonën pyjore të dhënë me qera. (Livadh – Hamzi, fshati Gojan i Vogël, njësi administrative Gjegjan).



9 Komuniteti Gjegjan

10 Komuniteti Gjegjan, Luf Qerret, Rrape, Qelëz;

11 Livadh, Hamzi për fshatin Gojan i vogël, pjesë e njësisë administrative Gjegjan

● DEMOKRACIA VENDORE ●

PJESËMARRJA NË VENDIMARRJE

Banorët shprehen se marrin njoftime për takime publike të organizuara nga bashkia, me atë të telefonit, njoftimeve në këndet e posaçme të bashkisë e të ngjashme. Gjithashtu ata shprehen se marrin pjesë në konsultime publike, por që mendimi i tyre nuk është marrë në konsideratë, prandaj edhe kanë listuar këtë çështje si disi prioritare, sepse banorët shprehen se nuk duan të jenë vetëm të pranishëm, por edhe të kenë mundësinë që mendimi i tyre të merret parasysh. *"Psh. Ne kemi kundërshtuar në lidhje me ndërtimin e hidrocentralit, por edhe pse ne jemi kundër, ai (hidrocentrali) po ndërtohet."*

Prioritet 22: Adresimi i problematikave të komunitetit dhe analizimi dhe marrja në konsideratë e mendimeve të tyre, në lidhje me vendimmarrje që ndikojnë drejtpërsëdrejti në komunitet.

Prioritet 23: Buxhetim me pjesëmarrje në mënyrë që qytetarët të marrin pjesë në vendimmarrjen mbi menaxhimin e financave publike të pushtetit lokal.

● ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR ●

MBËSHTETJA PËR FERMERËT

Banorët shprehen se pak u është ofruar shërbim këshillimi për bujqësinë. Por, ata shprehen se kanë marrë shërbimin veterinar dhe shërbime këshillimi në lidhje me të imtat, lopët dhe blegtarinë. Arsyeja se pse ata e kanë konsideruar në përgjithësi këtë çështje si disi prioritare është mungesa totale e incentivave dhe programeve specifike për ta dhe në veçanti për gratë fermere si dhe shërbimet për bujqësinë. Fermerët kërkojnë gjithashtu mbështetje financiare për ndërtimin e serave.

Prioritet 24: Zhvillimi i shërbimeve të këshillimit për bujqësinë si dhe ngritja e programeve për gratë fermere.

Prioritet 25: Mbështetje financiare për ndërtimin e serave.

Prioritet 26: Mbështetje me fonde për programe që mbështesin gratë fermere.

MBLEDHJA E TË ARDHURAVE DHE PLANIFIKIMI I BUXHETIT

Komuniteti i bashkisë Pukë i merr në kohë njoftimet për detyrimet e tarifave apo dhe taksave vendore, gjithashtu ata shprehen se i paguajnë detyrimet e tyre, por cilësojnë se tarifat e vendosura për disa shërbime specifike janë më të larta sesa shërbimi i ofruar. Gjithashtu, një kategori banorësh shprehen se të ardhurat ekonomike i kanë shumë të ulëta dhe kjo sjell vështirësi në pagesën e detyrimeve.

Prioritet 27: Përmirësimi i shërbimeve të bashkisë në nivelin e taksave si dhe shikimi i gjetjes së zgjidhjes për pagesat e këtyre taksave nga familjet në nevojë ekonomike.

ÇËSHTJE TË TJERA QË KOMUNITETI I BASHKISË PUKË KËRKON VËMENDJE:

Komuniteti i bashkisë Pukë, ngriti edhe disa çështje të tjera të cilat sipas tyre është e nevojshme që të ndërhyhet dhe të jepet zgjidhje, çështje të tilla si:

- Ngritja e një qendre për fëmijët dhe personat me aftësi ndryshe
- Ngritja e akademisë sportive (zhvillimi i shumë sporteve për aktivizimin rinor)
- Lobimi dhe mbështetja nga bashkia në lidhje me bursat e ekselencës
- Nevoja për hapjen e kurseve profesionale me bazë zhvillimin e aftësive për turizëm si një fushë prioritare e zhvillimit të Pukës duke sjellë kështu edhe rritjen e punësimit të të rinjve dhe grave.
- Zhvillimi dhe identifikimi i zonave turistike, tabelat informuese, shtigjet malore, informacion i zgjeruar për zhvillimin e zonës së Pukës.
- Krijimi i ditëve të veçanta për Pukën dhe organizimi i aktiviteteve të ndryshme gjatë këtyre ditëve, për të mundësuar kështu vizitat e turistëve vendas dhe të huaj.
- Kërkesa për të hapur një qendër rinore.
- Rishikimi i ndihmës ekonomike.

